
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Datë: 11.07.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i repartit të imazherisë dhe përshtatje e ambienteve për instalimin e pajisjes Scaner CT.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi, 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,663,816.27 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë pike njëzetë e shtatë) **Lek pa TVSH.**

PROCEDURA: E Hapur E Thjeshtuar –Punë, bazuar në nenin 49, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar

AFATI: 3 (tre) javë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor përfitues, i cili kërkon realizimin e punimeve.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë :

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës. *(Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit, bazuar në pikën 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vitit të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë ne mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ” *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarates të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Fatura tatimore per cdo situacion punimesh te deklaruar ne organet tatimore.

- 1.1** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- 1.2** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa, vlera limit e kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$3,663,816.27 \times 30\% = 1,099,144 \text{ leke}$$

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (a dhe b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave a dhe b të pikës 1, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkepunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-3A** (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.)

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-14A** Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 6 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar. Referuar kategorisë së kërkuar, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave dhe volumeve të preventivit të punimeve.

Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë,shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme
- b) Diplomë

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-3A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.	F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham Boje hidroplastike cilesi e larte Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Patinim muri allçi (stuko) Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm. Shtrese lluster cemento 1:2 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa F.V. Shrese dysHEMEJE me PVC mjeksore t=8mm etj.	A (0-20 milionë lekë)
NS-14A	Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV	F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2 F.V tub plastmasi Ø 18-21mm F.V tub plastmasi Ø 22-26mm F.V Çeles 1 polar 220V 10A F.V kuti suport pllaket 2 mod F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40 F.V priza shuko universal F.V kuti suport pllaket 4 mod F.V. Kutiderivacioni plastm F.V Tub fleksibel 40mm 750NM F.V Paneli elektrik Kryesore PEK me vanocavi, mbrotjtjet magneto termike dhe diferenciale, me sinjallizues dhe aksesori, porte xhami sipas skemes ne vizatim sipas tegjthe standartve F.V Paneli elektrik i kontrollit, me mbrotjtjet magneto termike dhe diferenciale, me sinjallizues dhe aksesori, sipas skemes ne vizatim sipas tegjthe standartve F.V Kabell FG16OM16 3*1.5mm2 F.V Kabell FG16OM16 3*2.5mm2 F.V Kabell FG16OM16 5*4mm2 F.V Kabell FG16OM16 5*6mm2 F.V Kabell Verdh - Jeshil FG16R16 1x 50mm2 F.V Kabell Verdh - Jeshil FG16R16 1x 70mm2 F.V Kabell FG16OM16 1x70mm2 F.V Tapa fallco F.V Kuti shperndarese me kapak & vida C5-C7 jasht murit F.V Kanaline metalike e birezuar Zn 150x75 F.V Kanaline plastike 150x100mm Kanaline plastike 200x80mm F.V Profil U 40x20x1.5 L=2m Zn F.V Xhunto per kanaline 60x75 sebashku me bulonat F.V Aksesore per kanaline Zn 150x75 mm (Kthesa, Kryqezime, Reduktoore mbylles fundore ne plan, ne ngjitje, kapak aksesoresh etj sipas rastit) F.V Upe metalike 0.8 F.V Perzhinier fi8mm F.V Ndricues katrore LED 45W antibakterial, 5000lm, 4000K me kase ter pershtatshme per montim jasht murit ose ne gips 60x60cm F.V Aksesori montimit ndryshem sipas rastit F.V Kabell rrjeti ,tip FTP-cat6 F.V Priza rrjeti FTP cat 6 RJ45 F.V Patch corda FTP cat 6 1ml F.V Buton alarmi F.V Llampe sinjalizuese JM F.V Kabell FG16OM16 1x95mm2	A (0-20 milionë lekë)

		F.V Sensor tymi konvencional tavanor F.V Pulsant alarm zjarri konvencional F.V Sirene e brendshme konvencionale F.V Sirene e jashtme IP65 konvencionale F.V Central alarm zjarri me 4 zona konvencional F.V Kabell alarm zjarri 1x2x1mm2, PH60 min etj.	
--	--	--	--

miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Një punësim prej minimumi 6 (gjashtë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 javësh nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 6 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierin e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Elektracist	1
Bojaxhi	1
Specialist Gipsi	1
Shofer	1

2.3.6/1 Për punonjesit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH DIN EN UNI **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në bazë të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.8 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt

prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që

kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim permbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zerrat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*), si dhe hapesirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes, Kontratës së Qirasë apo Huapërdorjes. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektin e zbatimit, bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qëndror blerës nga Autoriteti Kontraktor përfitues.